



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:071222
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05410568

Ac.nr.8512/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin, Delushe Halimi, e me bashkëpunëtoren profesionale Arjeta Sylja, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (KESCO) në Prishtinë, kundër debitorës A. E. A., nga Gj., me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.37/21, të datë 17.10.2022, jashtë seance me datë 05.03.2024, merr këtë,

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kreditorit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (KESCO) në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.37/21, të datë 17.10.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin CPK.nr.37/21, të datë 17.10.2022, nën pikën I të dispozitivit ka vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i datës 29.03.2021 i debitorit A. A., i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.93/21, të datës 22.03.2021 të përmbaruesit privat P. I. Xh., dhe pjesërisht shfuqizohet urdhri përmbarimor p. nr. 93/21, i datës 22.03.2021, për shumën prej 1,229.05€, ndërsa i njëjti urdhër mbetet në fuqi për shumën prej 557.65 €.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Kreditori propozon që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar, ashtu që të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi Urdhëri Përmbarimor P.nr.93/2020, i datës 22.02.2021 ose të Priset aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim ahe në rivendosje.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtares individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore, lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe vëren se:

Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, me datë 22.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstrakti nga librat afariste DGL... .

Përmbartuesi Privat, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit, me Urdhrin Përmbartimor P.Nr.93/21, të datës 22.03.2021, ka lejuar përmbartimin.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat, dhe e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin e përmbartuesit privat.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të kundërshtimit të debitorit, ka vendos si në dispozitiv të saj, duke e pranuar pjesërisht prapësimin dhe duke lënë jashtë fuqisë juridike urdhrin për përmbartim sa i përket shumës së borxhit prej 1.229.05 euro.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Gjykata e shkallës së parë, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, pasi që duke u bazuar në Urdhrin Përmbartimor, është lejuar përmbartimi për periudhën kohore prej 28.06.2017 deri më dt. 12.02.2021 dhe për këtë periudhë është kërkuar shuma prej 1,786.70€ të paguhet nga debitori. Gjykata, nga transaksioni i konsumatorit ka vërtetuar se nga dt. 28.06.2017-12.02.2021 debitori ka paguar detyrimin e tij për shfrytëzimin e energjisë elektrike në shumë prej 1,229.05€, ku sipas llogaritjes me matematikë të thjeshtë (1,786.70-1,229.05 557.65€) rrjedh se detyrimi i debitorit në raport me kreditorin, për periudhën nga dt. 28.06.2017 deri më dt. 12.02.2021 është 557.65€. Prandaj, për këtë arsye gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi që të shfuqizohet urdhri përmbartimor, sa i përket shumës prej 1,229.05€. Ndërsa për pjesën e lënë në fuqi, gjykata është bazuar në transaksionin e konsumatorit, shihet se debitori për periudhën kohore prej 28.06.2017 deri më dt. 12.02.2021 nuk e ka paguar në tërësi shumën e kërkuar nga ana e kreditorit, pra shumën prej 1,786.70€, por i njëjti ka paguar vetëm shumën prej 1,229.05€ për këtë periudhë, prandaj nga kjo shihet se i njëjti ka detyrim monetar në raport me kreditorin, në shumë prej 557.65€, andaj për këtë arsye është lënë në fuqi urdhëri përmbartimor, për këtë pjesë. Lidhur me pretendimin për parashkrim, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë nuk është i qëndueshëm, duke u bazuar në nenin 368 par.1 dhe 2 të LMD-ës për shkak se debitori kohë pas kohe ka kryer pagesa të energjisë elektrike, ku pagesë e fundit e ka kryer me datë 12.01.2021, pa e specifikuar faturën konkrete, ndërsa propozimi për përmbartim është paraqitur me datë 22.03.2021.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet e kreditorit të parashtruara në ankesë, se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, neni 182.1 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin e prapësimin e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e pranuar pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit dhe duke lënë pjesërisht në fuqi urdhrin përmbarimor, P.nr.93/21, të datës 22.03.2021, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike ku në bazë të ekstraktit nga librat afariste, gjegjësisht nga transaksionet e konsumatorit, është vërejtur se debitori ka bërë herë pas here pagesa për konsumin e energjisë elektrike, andaj, bazuar në shkresat e lëndës shuma e mbetur e borxhit të pa paguar është 557.65 euro sepse me kryerjen e pagesave shumat janë zbritur nga borxhi i përgjithshëm kështu duke mbetur vetëm shuma e pa paguar e cekur më lartë ashtu edhe siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, e jo siç pretendon kreditori me ankesë.

Gjykata ankimore e mbështet qëndrimin e Gjykatës së shkallës së parë lidhur me pjesën refuzuese të borxhit për faktin se për këtë Gjykatë rezulton të provohet se kreditori ka parashtruar propozim për përmbarim pranë Organit Përmbarues për periudhën nga data 28.06.2017 deri më datë 12.02.2021. Nga ekstrakti i librave afarist vërehet se gjatë kësaj periudhe debitori ka kryer pagesa të kohëpaskohshme, dhe kur kemi parasysh shumën e faturuar gjatë kësaj periudhe dhe pagesat e bëra nga ana e debitorit rezulton fakti se debitori i ka mbetur borxh kreditorit vetëm në shumën prej 557.65 euro. Shumën tjetër të cilën e ka kërkuar kreditori në përmbarim nuk ka arritur fare ta argumentoj se për cilën periudhë është, sepse e njëjta nuk përkon me periudhën e cila është kërkuar në propozim.

Kështu duke pasur për bazë shkresat e lëndës, kjo Gjykatë nuk e aprovon si të bazuar pretendimin se vendimi i gjykatë së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse kreditori me asnjë provë nuk ka arritur që ti bazojë pretendimet e veta në mënyrë që kjo Gjykatë të marrë vendim ndryshe nga ai si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8512/2022, datë 05.03.2024

Gjyqtarja
Delushe Halimi